



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr.104, Datë 29.06.2020

MBI

**MIRATIMIN E ‘OPINIONIT TË PËRBASHKËT TË RREGULLATORËVE TË ENERGJISË  
MBI KËRKESËN E TAP AG PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË  
VENDIMIT TË PËRJASHTIMIT’, NGA PARASHIKIMET E NENEVE 9, 32 DHE 41(6) DHE  
(8) DHE (10) TË DIREKTIVËS 2009/73/EC”.**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenet 44 dhe 49 të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të bordit të dates 29/06/2020,

**Në zbatim të:**

- Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: Direktiva 73/09);
- Rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009;
- Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në vijim Rregullorja 715/09);
- Vendimit Nr 27, datë 01.03.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE, “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP – AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline” ;
- Vendimit nr. 64, datë 13.06.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE “Për amendimin e Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE, nr. 27 datë 1.03.2013 “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC
- Vendim i Bordit të ERE, Nr.135, datë 24.12.2014 mbi”Opinionine përbashkët i rregullatorëve të energjisë mbi kërkesën e TAP AG për shtyrjen e periudhës së vlefshmërisë të vendimit të përjashtimit
- Kërkesës së datës 15 qershor 2020, që TAP AG i ka drejtuar autoriteteve të tre rregullatorëve, të Shqipërisë (ERE) të Italisë (ARERA), Greqisë (RAE), për shtyrjen e përjashtimit;

- Vendim i Komisionit European C(2013) 2949 datë 16.05.2013 mbi përjashtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik nga kërkesat e aksesit të palëve të treta, rregullimit të tarifave dhe veçimit të pronësisë përcaktuar në Nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës 2009/73/KE.
- Vendim i Komisionit European C(2015) 1852, date 17.03.2015 për shtyrjen e përjashtimit të Gazsjellësit Trans Adriatik nga disa kërkesa të aksesit të palëve të treta, rregullimit të tarifave dhe veçimit të pronësisë përcaktuar në Nenet 9, 32, 41(6), (8), dhe (10) Direktiva 2009/73/KE;
- Opinionit 1/2015 të Sekretariatit të Energjisë(EnC) më 17 Mars 2015, mbi shtyrjen e përjashtimit të interkonjektorit të Gazsjellësit Trans Adriatik për disa kërkesa sipas Direktives 2009/73/EC nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE);
- Vendimit Nr. 127 Datë 07.11.2013 “Mbi miratimin e metodologjisë së tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar /Final Joint Opinion” në kuadër të procedurës për përjashtimin e gazsjellësit TAP”;
- Dokumentave I-185503/01.07.2014 dhe I-190427/27.11.2014 të kompanisë TAP AG, me të cilën paraqitën për miratim nga Autoritetet Rregulatore të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë, kërkesën për zgjatjen e përjashtimit;
- Opinionin e Përbashkët të Rregullatorëve, mbi kërkesën që TAP Ag ka bërë për shtyrje të periudhës së vlefshmërisë të vendimit të përjashtimit datë 17.03.2015, paragrafi 4 i cili ndryshon paragrafin 4.10 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët (FJO);
- Paragrafi 4.10.2 i Opinionit Përfundimtar të Përbashkët përshkruan që në përputhje me Nenin 36 (9) të Direktivës së Gazit, Përjashtimi do të humbë efektet e tij 3 vjet pas miratimit në rastin kur ndertimi i TAP nuk ka filluar akoma dhe 6 vjet pas miratimit në rastin kur infrastruktura nuk është vendosur akoma në funksion, derisa Komisioni të vendosë që cdo vonesë tjetër është për shkak të pengesave kryesore përtej kontrollit të personit të cilit i është dhënë përjashtimi;

#### **Duke konsideruar që:**

- Në Gusht të vitit 2011, TAP AG paraqiti një kërkesë për përjashtim nga zbatimi i dispozitave të neneve 9,32 dhe 41(6) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC dhe në përputhje me dispozitat e nenit 36 të, të tre autoriteteve të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë.
- Në Qershor 2013, Autoritetet e Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë, i dhanë kompanisë TAP AG në mbështetje të nenit 36 të Direktivës 2009/73/EC, përjashtimi nga zbatimi i dispozitave të neneve 9,32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të kësaj Direktive për tubacioni Trans Adriatic Pipeline (TAP) për një periudhë 25 vjeçare nga fillimi i operimit të tubacionit. Në mbështetje të këtyre vendimeve, autoritetet e tre vendeve miratuan një tekst të përbashkët ‘‘Opinionin Përfundimtar i Përbashkët’’ i Rregullatorëve të Energjisë mbi aplikimin e përjashtimit të TAP AG;
- Pjesa 4 e Opinionit të Përbashkët të Autoriteteve’’, përcakton një kornizë të veçantë

rregullatore për menaxhimin dhe funksionimin e tubacionit TAP AG për çështjet e çertifikimit, rregullimit të tarifave si dhe të përdorimit të tubacionit dhe aksesit i palëve të treta në infrastrukture;

- Në përputhje me Nenin 11 të Vendimit të Komisionit Europian paragrafin 4.10 (2) të Vendimit të përjashtimit, të paragrafit 9 të nenit 36 të Direktivës, rezulton se përjashtimi do të pushojë vlefshmërinë pas skadimit të tre (3) vite nga miratimi i tyre nëse ndërtimi i tubacionit nuk ka filluar, dhe pas kalimit të gjashtë (6) viteve nga miratimi i tyre, nëse tubacioni nuk ka filluar periudhën e operimit;
- Zgjatja e përjashtimit mund të jepet vetëm kur Komisioni Evropian e ka miratuar vendimin e tij mbi përjashtimin për Greqinë dhe Italinë dhe pasi ka marrë parasysh opinionin për ERE nga EnC
- Ndërtimi i tubacionit filloi në kohë, dhe konkretisht më 16 Maj 2016;
- Në datën 27.06.2014 dhe në datën 17.12.2014, kompania TAP AG kërkoi zgjatjen e përjashtimit nga parashikimet e neneve 9,32, dhe 41(6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC, për shkak të arsyeve të cilat nuk janë në kontroll të tij që do të thote një vonesë në disponueshmëri në rrjedhjen e siperme të gazit nga Konsorciumi Shah Deniz në Azerbajxhan, dhe rrjedhimisht në fillimin e funksionimit të tubacionit TAP;
- Autoritetet kompetente nxorren përfundimin që për të shtyre datën kur ‘infrastruktura e TAP të behet funksionale’ (që do të thote datën komerciale të funksionimit), kërkohet një modifikim nga Autoritetet kompetente i opinionit të perbashket mbi përjashtimin, sipas të njëjtës procedurë si për nxjerjen e tij nga Autoritetet kompetente të Vendimit fillestar Përfundimtar të Perbashket mbi përjashtimin, duke përfshirë përfshirjen e Komisionit Europian dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjise;
- TAP AG jep justifikimet e mëposhtme për kërkesën për shtyrjen e datës kur ‘infrastruktura të vendoset në funksion’ (që do të thote data komerciale e operimit):
  - a. Pengesat në lidhje me lejet në Itali. Autoriteti kompetent Italian vendosi 65 kushte, të cilat u vlerësuan dhe miratuan nga një numër i konsiderueshëm i autoriteteve lokale dhe rajonale. Për më tepër, ndalimi i ndërtimit të projektit të TAP midis 1 qershorit dhe 30 shtatorit të çdo viti, si dhe procedurat administrative autonome për heqjen/depozitimin e ullaëve, vonuan periudhën e ndërtimit të projektit për rreth një vit;
  - b. Shkelje të rënda të sigurisë në Itali.
  - c. Nevoja për të zbatuar vazhdimisht një seri masash për sigurinë e vendeve të ndërtimit në Itali si dhe punëtorët që do të punonin atje, duke shtuar këtu edhe qëndrimin e organizatave lokale dhe rajonale që shpesh u manifestuan me protesta të dhunshme;
  - d. Procedura të ndryshme ligjore dhe gjyqësore, përfshirë edhe një urdhër konfiskimi i cili shkatoi 8 muaj vonesë;
  - e. Pandemia e shkaktuar nga virusi COVID-19, i cili në mënyrë të pashmangëshme vonoi punimet për një kohë të gjatë dhe shkatoi probleme dhe vonesa në transportimin e materialeve dhe të punëtorëve;

- TAP AG kërkoi një zgjatje të datës kur ‘infrastruktura të vendoset në funksion’ (që do të thotë datën komerciale të funksionimit) me një vit, deri ne 31 Dhjetor 2021, në veçanti për shkak të justifikimeve të përmendura me sipër, përfshirë pasigurinë e krijuar nga mundësia e një vale të re të pandemisë të shkaktuar nga virusi COVID-19;
- Autoritetet Rregullatore të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë, në bashkëpunim të ngushtë midis tyre, kanë vendosur që procedura e përshkruar më sipër duhet të ndiqet përsëri;
- Autoritetet Rregullatore të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë, bashkëpunuan ngushtësisht në ekzaminimin dhe vlerësimin e kësaj kërkesë të kompanisë TAP AG, dhe vendosën në favor të stabilitetit, të argumentave të kërkuara dhe plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 36(9) të Direktivës 2009/73/BE, duke konfirmuar pretendimin e kompanisë se vonesa e mundëshme në përfundimin e ndërtimit të tubacionit dhe fillimit të tij në fazën e operimit tregtar, nuk bën pjesë në sferën e ndikimit të kompanisë TAP AG.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE

### **Vendosi**

1. Miratimin e ‘Opinionit të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi kërkesën e TAP AG për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit të Përyjashtimit’, për zgjatjen e vlefshmërisë së vendimit të përyjashtimit dhe që i bashkëlidhet këtij vendimi si ‘Shtojca A’ dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Të propozojë për të ndryshuar paragrafin 4.10, të ‘Opinionit të Përbashkët të Autoriteteve, në përputhje me pikën 2 të aneksit të Shtojcës.
3. Njoftimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Ministrinë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteteve Rregullatore të Energjisë të Italisë (AEEG) dhe Greqisë (RAE) dhe TAP AG, për marrjen e këtij Vendimi, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 36 të Direktivës

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**